



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



NJOFTIM

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 67, pika 1, si dhe mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës, kërkon të punësojë për 2 (dy) vende pune për personel akademik me kohë të plotë, kategoria "Asistent – lektor" në Departamentin e Gjuhës Angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja:

- **Personel akademik me kohë të plotë, kategoria "Asistent-Lektor", 2 (dy) vende pune**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare ose studimet Master Shkencor (3 + 2 vjeçare) në fushën e gjuhës angleze;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
5. Të mos jetë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna;

Kritere të veçanta:

1. Të ketë diplomë universitare në dy cikle të studimeve:
 - a) Cikli i Parë i Studimeve në Gjuhë Angleze (drejtimet Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike e Amerikane), notë mesatare mbi 9.5;
 - b) Cikli i Dytë i Studimeve, "Master i nivelit të dytë" në programet e Gjuhësisë ose Letërsisë, me notë mesatare mbi 9;
 - c) Cikli i Dytë i Studimeve, Master i Shkencave në Gjuhë Angleze (Mësuesi në Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Gjuhë dhe Komunikim), notë mesatare mbi 9.5.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



2. Preferohen kandidatë me diplomë të integruar të nivelit të dytë (sistemi 4-vjeçar) në drejtimet Mësues i Gjuhës Angleze për shkollën e mesme, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike e Amerikane, notë mesatare mbi 9;
3. Preferohen kandidatë me përvojë mësimdhënie pa shkëputje gjatë 5 viteve të fundit në Institucione të Arsimit të Lartë;
4. Preferohen kandidatë të përfshirë në kualifikime postmaster dhe/ose në programin doktorat në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Kandidatët që aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
2. Kërkesë me shkrim ;
3. Dokument identifikimi;
4. Fotokopje e diplomës (të notuar);
5. Fotokopje e listës së notave (të notuar);
6. Dëshmitë për kualifikimet dhe aktivitetet lidhur me temën e aplikimit;
7. Të paktën 2 (dy) referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
8. Në rast të përfundimit të studimeve jashtë vendit kandidati do të paraqesë edhe ekuivalentimin e Diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (të notuar).
9. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
10. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
11. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi;
12. Çertifikatë personale.
13. Çertifikatë e gjendjes familjare

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data **31/08/2026 – 14/09/2026**.